“Kur të biesh në sexhde, lëshoji shuplakat në tokë e ngriji bërrylat.”

Berai (Allahu qoftë i kënaqur me të!) transmeton se i Dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: “Kur të biesh në sexhde, lëshoji shuplakat në tokë e ngriji bërrylat.”
[Sahih] [Transmeton Muslimi]

Profeti ﷺ në këtë hadith e sqaroi pozicionin e duarve gjatë sexhdes në namaz: Duart duhet të vendosen në tokë me gishtat e bashkuar dhe të drejtuar nga Kibla, ndërsa bërrylat, pra nyja mes parakrahut dhe krahut të sipërm duhet të jenë të ngritura, të mos prekin tokën dhe të mbahen larg nga anët e trupit.

http://sunnah.global/hadeeth/sq/show/10927